



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT

Data 20.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV RINOVIMI I SHITESËS SË TARTANIT NË
AKADEMINË E CIKLIZMIT”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
_14212410-7 Shtresë e punueshme**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës

**Fondi limit i procedurës është: 2.333.333 (dymilion e treqind e tridhjetë e tremijë e
treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë
23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave
citet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa
vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të
vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në
rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren 46.666,66 (dyzetë e gjashtëmijë
e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë të lëshuar në formën
e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285,
datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të
tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës

nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

2.1.2 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 14001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit mjedisor, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO)

2.1.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 45001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO)

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë

së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objektit të prokurimit) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë furnizim vendosje te shtresës së tartanit duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objektit të prokurimit) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat nën kufirin e ulet monetar.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të ketë realizuar xhiro në fushën e objektit të prokurimit, njësisia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....,*

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare. Në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në gusht të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 466 666.6 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i se njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Numri mesatar i punonjësve të siguar duhet të jetë jo më pak se **6 (gjashte) punonjës** për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës është bazuar tek fakti, që është kërkuar që operatori ekonomik të ofrojë furnizimin e mallit (tartan) si dhe të realizojë vendosjen e tij në objektet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Stafi sa më sipër përcaktuar konsiderohet i nevojshëm për realizimin e transportit dhe vendosjen e shtresës së tartanit .

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr.	Mjetet	Sasia	Mënyra e posedimit
1	Kamion me vinç	1	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi si dhetë shoqërohet me aktin e pronësise se qeradhenesit.
- b) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetit për transportin e mallit, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 ”Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialin tartan. Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë te dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkojnë të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumenta teknike për artikullin objekt prokurimi si skeda teknike të produktit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

FV rinovim i shtresës së tartanit pranë Akademisë së Ciklizmit me trashësi minimale 10 mm, për sipërfaqen e këndit të lojrave pranë Akademisë së Ciklizmit në PMLAT, me një sipërfaqe totale prej 250 m².

Vendosja e shtresës së tartanit është një proces që kërkon ndjekjen e procedurave të rrepta për të siguruar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe performancën e sipërfaqes.

1. Përgatitja e Sipërfaqes

1.1 Sipërfaqja Bazë

- Përshtatja e bazës prej betoni për të siguruar qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e nevojshme.
- Sipërfaqja bazë duhet të jetë e rrafshët dhe pa plasaritje apo gropa.

1.2 Pastrimi I Sipërfaqes

- Para aplikimit të tartanit, sipërfaqja bazë duhet të pastrohet plotësisht nga pluhuri, vajrat, yndyrat apo papastërtitë e tjera.
- Sipërfaqja duhet të jetë e thatë për të siguruar ngjitjen e mirë të materialeve përbërëse.

2. Materialet

2.1 Primeri (Përgatitës ngjitës)

- Shtresa e primerit duhet të aplikohet mbi sipërfaqen bazë për të siguruar ngjitjen e tartanit.
- Primeri duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe betoni ose asfalti dhe të përmbushë të gjitha standardet e sigurisë.

2.2 Rërë kuarci 04-08

2.3 Granulat e Gome 1.0-3.0 mm

- Granulat e gomës janë materiali kryesor i përdorur për tartanin.
- Granulat duhet të jenë të prodhuara nga goma SBR (styrene-butadiene rubber) ose EPDM (ethylene propylene diene monomer rubber), të cilat janë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj faktorëve të jashtëm.

2.4 Lidhësi (Binders)

- Lidhësi polimerik përdoret për të përzier granulat e gomës dhe për të krijuar një shtresë të qëndrueshme.
- Poliuretani është lidhësi që do të përdoret duke ofruar një ngjitje sa më të mirë dhe të qëndrueshme.

2.5 Pigmentet dhe Ngjyrat

- Pigmentet do të përdoren për të dhënë ngjyrën e dëshiruar sipërfaqes së tartanit.
- Pigmentet duhet të jenë rezistente ndaj rrezeve UV për të shmangur zbehjen me kalimin e kohës.

3. Procesi i Aplikimit

3.1 Aplikimi i Primerit

- Primeri do të aplikohet përgjatë gjithë sipërfaqes së kërkuar.
- Primeri duhet të lihet të thahet plotësisht përpara aplikimit të shtresës së tartanit.

3.2 Përzierja e Materialeve

- Granulat e gomës duhet të përzihen me lidhësin polimerik në proporcionet e duhura për të siguruar një masë homogjene.
- Pigmentet për të marrë ngjyrën e dëshiruar do ti shtohen përzierjes gjatë procesit të punës.

3.3 Aplikimi i Shtresës së Tartanit

- Masa e përzier e tartanit do të aplikohet mbi sipërfaqen e përgatitur, duke përdorur makinat dhe pajisjet e posaçme për një trashësi jo më të vogël se 10 mm
- Shtresa duhet të rrafshohet dhe kompaktimohet për të siguruar një sipërfaqe të barabartë dhe të qëndrueshme.

3.4 Shtresa Përfundimtare

- Shtresa përfundimtare do të aplikohet për ti dhënë qëndrueshmëri dhe rezistencë sipërfaqes së shtruar.
- Shtresa përfundimtare mund të përmbajë shtresa shtesë ngjyre për të përmirësuar pamjen dhe rezistencën ndaj faktorëve të jashtëm.

4. Testimi dhe Mirëmbajtja

4.1 Testimi i Cilësisë

- Pas përfundimit të shtrimit, sipërfaqja duhet të testohet për të siguruar që përmbush standardet e kërkuara për elasticitet, qëndrueshmëri dhe siguri.
- Testimet duhet të përfshijnë matjen e trashësisë së shtresës, qëndrueshmërinë ndaj presionit dhe rezistencën ndaj rrëshqitjes.

Për realizimin e procesit të shtrimit të tartanit si një procedurë komplekse duhet të përdoren të gjithë produktet e nevojshme dhe në raportin e duhur për përzierjen e tyre.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Njësia e Prokurimit Publik

